

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	PS: Pagat në drejtësi rriten 0.02 %! PD voton kundër, magjistratët: Do ta godasim në Gjykatën Kushtetu ese – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/pagat-e-magjistrateve-komisioni-i-ligjeve-miraton-draftin-e-ps-me-8-vota-pro/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 15:11:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 15:06:41 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	80c0924c190649d64cd00e207db073e4afbfc3a92273fd9693554348c99aaafa
TEKSTI	e379806d5f236e330c6267129bc8f559e055eef76e790de25a02a405346c625e
PAMJA	f1d88edbb216f89de24e36215141311089a42fd88d4f09bd61bd533cf255261e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	db5a37e8bfed269344c4de4e59adcd40bbdd3def8fdf478d18a24f8fc4b93443
E MËPARSHMJA	879ea7e4b7bd5099360faa759c9e92f454e884424c750b7cd1e5980720c0b197
RRËNJA MERKLE	80f8ed3d4c77708449a259db492a6c9a12b9addcf62e639a2bd2cb31edd1709
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/db5a37e8bfed269344c4de4e59adcd40bbdd3def8fdf478d18a24f8fc4b93443>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



e pagave u zhvendos në Parlament, në komisionin e ligjeve ku u diskutua projektligji për rritjen e rrogave të gjyqtarëve e prokurorëve.

Mbledhja zgjati 5 orë dhe Partia Socialiste e ndryshoi 3 herë brenda kësaj mbledhje projektligjin për pagat e gjyqtarëve.

Në fillim të mbledhjes u paraqit propozimi i socialistes Aulona Bylykbashit që u rriste pagën gjyqtarëve dhe prokurorëve me 0.02%; ndërkohë që pagën e SPAK-ut dhe Gjykatës së Posaçme e rriste 80%; pagën e Gjykatës së Lartë e rriste 85% dhe pagën e Gjykatës Kushtetuese po 85%.

Në mes të mbledhjes socialisti Erald Pacaj paraqiti një version të ri.

Dhe në fund të mbledhjes u paraqit nga Erald Pacaj një draft i tretë. Ky draft hiqte rritjen e pagës në nivelin 80 dhe 85% për SPAK-un, Gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese. Drafti hoqi edhe shtesën prej 2% për çdo vit eksperiencë për anëtarët e Gjykatës së Lartë. Gjithashtu socialistët u kujdesën që të saktësojnë se kjo rritje nuk do të aplikohet për zyrtarët, paga e të cilëve lidhet me pagën e gjyqtarit.

Projektligji final parashikon vetëm rritjen e pagës për të gjithë gjyqtarët e prokurorët në masën 0.02% dhe mori mbështetjen e 8 deputetëve socialistë ndërkohë që demokratët votuan kundër.

"Qeveria vendos që me arrogancë të injorojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Është hera e parë? Jo! Nuk e di e sata herë është që qeveria vendos të refuzojë zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. "E dimë ne! Madje, madje bllokojmë dhe pagat!" Mjafton ta lexosh vendimin e

5 Gjykata e Lartë lë në burg Erion Veliajn

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

emaili juaj

Abonohu

Gjykatës Kushtetuese dhe e kupton që propozimi që ka ardhur sot në të tre format që erdhi sot nuk respekton vendimin e Gjykatës Kushtetuese”, tha Oerd Bylykbashi, nënkryetar i Komisionit të ligjeve, PD.

“Është Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ai që jep autorizimin ligjor dhe nuk thotë Gjykata Kushtetuese që ka një organ tjetër që mund të disponojë sipas Kushtetutës preken e buxhetit të shtetit përveç se me ligj të Kuvendit”, tha Ulsi Manja, kryetar i Komisionit të Ligjeve, PS.

Demokratët nuk ishin të vetmit që kundërshtuan projekt-ligjin e hartuar nga socialistët. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Gjykata e Lartë, Shoqatat e prokurorëve dhe Gjyqtarëve dhe kanë deklaruar se kjo formulë nuk respekton vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

“Qëllimi nuk është thjesht miratimi i një ligji, por miratimi i një ligji që zbaton vendimin e Gjykatës Kushtetuese”, tha Ilir Panda, Gjykata e Lartë.

“Formula e sjellë në këtë projekt është shumë larg asaj formule e cila tashmë ka hyrë në fuqi, e them kjo formulë ka hyrë në fuqi”, u shpreh Engert Pëllumbi, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve.

Dhe paralajmërimi i prokurorëve dhe gjyqtarëve ishte i qartë, beteja me qeverinë nuk përfundoi sot.

“Sepse gjykatësit dhe prokurorët do të shkojnë në Gjykatën Kushtetuese të kërkojnë zbatimin e atij vendimi të Gjykatës Kushtetuese dhe gjasat janë, pa bërë profetin, që vendimi do të jetë i njëjtë”, u shpreh Gerd Hoxha, Unioni i Gjyqtarëve.

Parlamenti ka parashikuar që projektligji për pagën e gjyqtarëve e prokurorëve të diskutohet në seancë të enjten në datë 17 shtator.

/vizionplus.tv

#gjyqtaret

#KomisioniLigjeve

#paga

#PartiaSocialiste

#VizionPlus



Xhuljana Zhuleku

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



KRONIKË

**Ergys Kolaveri
rrezikon dënimin,...**

Xhuljana
Zhuleku

2 orë më
parë



KRONIKË

**Aksident në
superstradën Lezhë-...**

Xhuljana
Zhuleku

2 orë më
parë



KRONIKË

**Përplasen makinat në
Dibër, lëndohen 5...**

Xhuljana
Zhuleku

3 orë më
parë

Lini një koment

Komenti juaj *

Me respekt — komentet moderohen nga redaksia.

Emri *

E-mail *

Nuk publikohet kurrë.

☐ Ruaje emrin dhe e-mailin tim në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto komentin



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

• LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv

Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.